



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORT MONITORIMI

**MBI SHKELJET E KONSTATUARA
NË PROCEDURËN E EKSTRADIMIT
TË SHTETASIT RUS I.K NGA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË NË
FEDERATËN RUSE**

**18 Shkurt
2025**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

18 Shkurt 2025

RAPORT MONITORIMI

MBI SHKELJET E KONSTATUARA NË PROCEDURËN E EKSTRADIMIT TË SHTETASIT RUS I.K NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË NË FEDERATËN RUSE

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në ushtrim të misionit të tij, më datë 10.10.2024 është njohur me ankesën e përcjellë në rrugë postare, nga avokati i shtetasit rus I.K, në lidhje me procedurën që po ndiqej nga autoritetet shqiptare për ekstradimin e tij drejt Federatës Ruse.

Nga të dhënat lidhur me këtë ankesë, rezulton se me kërkesë të autoriteteve ruse (Interpol NCB Moskë), ky shtetas ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, për shkak se ndaj tij, gjykata e Moskës, në datë 18.02.2022 ka dhënë masë sigurimi arrest në burg, si i dyshuar për kryerjen e një veprë penale¹. Shtetasi Rus I.K, rezulton se është arrestuar në datë 27.08.2023 nga Drejtoria Vendore e Policisë së Shkodrës dhe me vendimin e datës 14.11.2023, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka vendosur ekstradimin e tij në Federatën Ruse.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, më datë 20.02.2024 si dhe me vendimin e Gjykatës së Lartë, të datës 24.09.2024. Në datë 09.10.2024 avokati i shtetasit I.K, ka depozituar pranë Gjykatës Kushtetuese kërkesën me objekt: *“Pezullimin e vendimit nr. 00-2024-1533 datë 24.09.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”*, i cili lejon ekstradimin e shtetasit I.K në Federatën Ruse.

Në datë 14.10.2024, Ministri i Drejtësisë ka miratuar urdhërin e ekstradimit të shtetasit I.K, duke vendosur si afat për ekstradimin datën 30.10.2024, ora 18:20.²

Nisur nga faktet e mësipërme si dhe informacioni se shtetasi I.K më datë 03.10.2023, kishte aplikuar për të përfitur azil në Republikën e Shqipërisë³, KShH më datë 18.10.2024 ju drejtua Departamentit për Kufirin dhe Migracionin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për të marrë informacion mbi fazën në të cilën ndodhej shqyrtimi i

¹ “Marrja e një pozicioni më të lartë në hierarkinë penale” të parashikuar nga neni 201/a i Kodit Penal të Federatës Ruse.

² Urdhër të cilin KShH nuk e disponon, por ai citohet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 15 (1), datë 30.10.2024. Bazuar në parashikimet e nenit 499 të Kodit të Procedurës Penale ku parashikohet se “Ministria e Drejtësisë i komunikon shtetit kërkues vendimin dhe, kur ky është pozitiv, vendin e dorëzimit dhe datën nga fillimi i së cilës do të jetë e mundur të veprohet. Afati i dorëzimit është pesëmbëdhjetë ditë nga data e caktuar dhe me kërkesë të arsyetuar të shtetit kërkues mund të zgjatet edhe pesëmbëdhjetë ditë të tjera. Kur ka shkaqe që nuk varen nga palët, mund të caktohet një datë tjetër dorëzimi, por gjithmonë duke u zbatuar afatet e caktuara në këtë paragraf.”

³ Sipas parashikimeve të nenit 32, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, ekstradimi i një personi nuk mund të lejohet kur në kohën e paraqitjes së kërkesës për ekstradim ai ka aplikuar apo i është dhënë azil në Shqipëri ndaj shtetit kërkues.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

kërkesës. Fillimisht, informacioni i kërkuar nuk na u vendos në dispozicion nga ky institucion. Vetëm përmes shkresës së datës 11.12.2024, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin informoi KShH-në se nuk dispononte kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare për shtetasin rus I.K.⁴

Gjithashtu, KShH është njoftuar se në datë 23.10.2024, ankuesi i është drejtuar Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) me kërkesën urgjente me objekt: “Marrjen e masës së përkohshme të mosekstradimit të I.K në Federatën Ruse deri në përfundimin e procedurës në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut, përveç nëse krijohen rrethana të reja që kërkojnë heqjen e masës së përkohshme.” GJEDNJ ka kërkuar informacionin e mëposhtëm nga autoritetet shqiptare deri më datë 8.11.2024:

1. Kur ka në plan të vendosë Gjykata Kushtetuese për kërkesën e aplikantit për të pezulluar ekstradimin e tij në Rusi?

2. A do të njoftohet aplikanti paraprakisht për largimin e tij në Rusi?

Sipas informacionit zyrtar të marrë nga Ministria e Drejtësisë, dorëzimi i shtetasit pranë autoriteteve Ruse për qëllim ekstradimi u realizua në Aeroportin e Rinasit më datë 30.10.2024, në **orën 16:45**.⁵ Menjëherë me marrjen dijeni për këtë ngjarje, KShH reagoi publikisht përmes deklaratës për shtyp të datës 04.11.2024⁶, lidhur me procedurat që institucionet përgjegjëse kishin ndjekur për rastin në fjalë. Shqetësimet dhe rekomandimet e shprehura në deklaratë ju përcollën në rrugë zyrtare më datë 05.11.2024 edhe Gjykatës Kushtetuese, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, Prokurorisë së Përgjithshme, Avokaturës së Shtetit dhe Interpol Tiranës.

Gjetjet dhe konkluzionet e këtij raporti bazohen në dokumentacionin zyrtar që KShH-së i është vendosur në dispozicion nga avokati i çështjes si dhe nëpërmjet korrespondencës së shkëmbyer nga KShH me disa institucione, të cilat do të analizohen në vijimësi të këtij raporti. Për rrjedhojë, nga pikëpamja metodologjike KShH kufizohet në konkluzionet lidhur me këtë çështje, bazuar në këto të dhëna zyrtare.

- **Procedura e ndjekur për ekstradimin**

Pasi KShH reagoi publikisht me deklaratën e tij për shtyp, e përcolli këtë deklaratë tek institucionet përgjegjëse⁷ dhe njëkohësisht kërkoi informacion zyrtar prej tyre, për mënyrën se si ishte realizuar procesi i ekstradimit, duke theksuar rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut dhe ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e përkohshëm të ekstradimit.

⁴ Ndërkohë që avokati i shtetasit I.K na ka vendosur në dispozicion kërkesën për azil të depozituar përmes shërbimit postar më datë 03.10.2023.

⁵ Ky informacion konfirmohet edhe nga qëndrimi i mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në deklaratën për shtyp.

⁶<https://ahc.org.al/deklarate-per-shtyp-veprime-te-nxituara-ose-te-vonuara-ne-shkelje-te-rende-te-standarteve-per-ekstradimin-e-shtetasit-rus-i-k/>

⁷ Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Gjykata Kushtetuese, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtoria Interpolit pranë Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KShH është informuar se më datë 30.10.2024, ora 17:15, Gjykata Kushtetuese ka thirrur me urgjencë Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe përmes vendimit nr. 15 (1)⁸ vendosi pezullimin e përkohshëm të procedurës së ekstradimit të këtij shtetasi, duke e arsyetuar këtë vendim, me mospublikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që lë në fuqi ekstradimin si dhe për faktin që Federata Ruse nuk është më pjesë e Këshillit të Evropës, bazuar në pretendimet e tij lidhen me mbrojtjen e të drejtave konventore (KEDNJ), si dhe për faktin se Gjykata e Strasburgut (GJEDNJ) në vitin 2022 ka konstatuar për këtë shtetas shkelje të neneve 3 dhe 5 të KEDNJ.

Gjykata Kushtetuese, duke patur parasysh orën e ekstradimit të caktuar në Urdhërin e Ministrisë të Drejtësisë (18:20), vendimin për pezullimin e përkohshëm të ekzekutimit të procedurave të ekstradimit të shtetasit e ka marrë vetëm 1 orë e 5 minuta para orës së ekstradimit, të urdhëruar nga Ministri i Drejtësisë. Në deklaratën e cituar më herët të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, si dhe shkresës së Ministrisë së Drejtësisë, KShH është informuar se vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i datës 30.10.2024 për pezullimin e përkohshëm të ekstradimit është dërguar në adresën elektronike të Drejtorisë për Marrëdhëniet Juridiksionale me Jashtë në orën 17:53, jashtë orarit zyrtar të punës. Ministria e Drejtësisë thekson se ekstradimi është kryer në përputhje me të gjitha procedurat ligjore dhe të drejtat ndërkombëtare.

Ndërkohë që sipas qëndrimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, menjëherë me marrjen dijeni për vendimin e mësipërm të Gjykatës Kushtetuese nga ana e Interpolit Tirana i është kërkuar informacion Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme nëse duhet të vijonte procedura e ekstradimit. Në mungesë të kësaj përgjigjeje, avioni ku ndodhej shtetasi I.K u nis në orën 18:20, edhe pse ai ishte marrë në dorëzim nga pala ruse që në orën 16:45.

KShH vlerëson se mos koordinimi i veprimeve të mësipërme si dhe vonesat në procedurat e ndjekura janë shoqëruar me pasoja të dëmshme. Ndërsa procedurat për ekstradim pezullohen me një vendim të detyrueshëm të Gjykatës Kushtetuese, I.K është ekstraduar. Mosekzekutimi i vendimit të përkohshëm të Gjykatës Kushtetuese ka cenuar jo vetëm të drejtën për një proces të rregullt ligjor, por edhe procesin e mbrojtjes që shteti Shqiptar duhet t'i ofrojë shtetasve të huaj që ekstradohen, kur ata pretendojnë se në vendet e origjinës (vendi kërkues) do i nënshtrohen torturës dhe trajtimit ç'njerëzor. Kjo bie ndesh me garancitë procedurale të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që ndalon në terma absolutë torturën dhe trajtimin ç'njerëzor.

Gjykata Kushtetuese duhet të bënte çdo përpjekje që ky vendim jo vetëm të dërgohej me email, por edhe ti komunikohet në kanale të tjera zyrtare autoriteteve të cilave ai ju drejtohet, përkatësisht Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Interpolit në Policinë e Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Avokaturës së Shtetit (qoftë edhe me anë të telefonit zyrtar). Në vijim, i gjithë zinxhiri i aparatit shtetëror të këtyre institucioneve duhet të vendosej në lëvizje menjëherë, që ekstradimi i shtetasit rus të mos ndodhte.

Mungesa e bashkëpunimit dhe e komunikimit në kohë reale mes institucioneve të përfshira, vihet në dukje edhe nga qëndrimi zyrtar që ka mbajtur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së

⁸ Avokati i shtetasit I.K kishte depozituar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, më datë 09.10.2024.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Shtetit, se pas marrjes dijani për vendimin e Gjykatës Kushtetuese ka qenë në pritje të një udhëzimi nga Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme, deri në orën që përkon me nisjen e avionit nga aeroporti “Nënë Tereza”. Pra, rezulton se Policia e Shtetit ka marrë dijani në kohë reale për vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve (pavarësisht se është dhënë jashtë orarit zyrtar), ndërkohë Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk kanë mbajtur asnjë komunikim me institucionet e përfshira në procedurën e ekstradimit, pavarësisht se kanë qenë në dijani të procesit të nisur si para Gjykatës Kushtetuese, ashtu edhe pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, mbi pezullimin e saj.

Vlen të saktësohet se GJEDNJ ka kërkuar informacion nga autoritetet shqiptare para procesit të ekstradimit duke i pyetur se kur do vendosë Gjykata Kushtetuese për kërkesën e aplikantit për të pezulluar ekstradimin e tij në Rusi? Atëherë si është e mundur që institucioni që ka urdhëruar ekstradimin dhe supervizon Avokaturën e Shtetit, Ministria e Drejtësisë nuk merr në konsideratë zhvillimet e pritshme nga Gjykata jonë Kushtetuese, që mund të ndikojnë potencialisht në pezullimin e procesit të ekstradimit? Në këtë situatë, asnjë shkak ligjor nuk është paraqitur për urgjencën e këtij ekstradimi nga Ministria e Drejtësisë dhe nevojën për të respektuar në mënyrë strikte afatet e vendosura në Urdhërin e Ekstradimit, sa kohë autoritetet po gjykonin një kërkesë për pezullimin e zbatimit të këtij urdhëri.

KShH ka konstatuar veprime të vonuara edhe nga Gjykata Kushtetuese, në kushtet kur kërkesa për pezullimin e procedurës së ekstradimit ishte depozituar pranë saj që më datë 09.10.2024. Gjatë 21 ditëve (nga momenti i depozitimit të kërkesës nga shtetasi I.K dhe deri në marrjen e vendimit), rezulton se Gjykata Kushtetuese nuk ka ndërmarrë asnjë hap për shqyrtimin e kërkesës, duke sjellë shqyrtimin e saj në limitet e afateve të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë që kishte miratuar ekstradimin. Në kushtet kur tashmë shtetasi I.K është ekstraduar drejt Federatës Ruse, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka vetëm efekt deklarativ dhe nuk i ka shërbyer mbrojtjes dhe respektimit të standardeve ligjore kombëtare e ndërkombatare në kuadër të nenit 2 (e drejta e jetës) dhe nenit 3 (ndalimi i torturës) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

Situata të ngjashme, ku procedurat e ekstradimit janë kryer nga autoritetet shqiptare në mungesë të dhënies së garancive nga shtetet kërkuese, si dhe pa pritur vendimet e gjykatave vendase janë hasur edhe më parë në vendin tonë. Në rastin e çështjes *Rrapo kundër Shqipërisë*, kërkuesi u ekstradua drejt SHBA-së në mungesë të një vendimi përfundimtar ndaj tij, duke mos u pritur vendimi i Gjykatës së Lartë. Vetëm pas përfundimit të procedurës, Gjykata e Lartë prishi vendimet e gjykatave të faktit, për shkak se procedura e ekstradimit ndaj tij ishte miratuar pa marrë garancitë e nevojshme mbi të drejtën e jetës. Ky rast, i shërbeu ligjvënësit si shtysë për të ndryshuar parashikimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale në vitin 2017.⁹

Institucionet përgjegjëse nuk kanë respektuar parashikimet e nenit 32, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, ku parashikohet se ekstradimi i një personi nuk mund të lejohet kur në kohën e paraqitjes së kërkesës për ekstradim ai ka aplikuar apo i është dhënë azil në Shqipëri ndaj shtetit kërkues. Përfaqësuesi i shtetasit I.K ka provuar përmes dokumentacionit të plotë se kërkesën për

⁹ Tashmë parashikohet që në rastet e ekstradimit apo transferimit të personave të dënuar, vendimi i Gjykatës së Lartë do të konsiderohet si vendim i formës së prerë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

përfitimin e azilit e kanë depozituar më datë 03.10.2023, duke vënë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin, Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Tiranë, Ministrinë e Brendshme dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. KShH vlerëson së përgjigjja e Departamenti për Kufirin dhe Migracionin se nuk dispononte kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare për shtetasin rus I.K., ngre dyshime të arsyeshme mbi respektimin e procedurave ligjore në fuqi dhe nuk i shërben parimit të transparencës së organeve shtetërore.

Tërheq vëmendjen se gjykatat shqiptare kanë lejuar ekstradimin e shtetasit I.K në Federatën Ruse, pavarësisht se është e njohur tashmë situata në të cilën ndodhet ky shtet, duke pasur parasysh agresionin rus ndaj Ukrainës, por edhe kushtet e veçanta të lidhur me këtë shtetas, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konstatuar më herët në një vendimmarrje të saj se i është nënshtruar trajtimit ç'njerëzor dhe degradues në sistemin e burgjeve të këtij shteti.

- Konkluzione dhe rekomandime

1. KShH vlerëson se si pasojë e vonesave në shqyrtimin e saj si dhe mos koordinimit midis organeve përkatëse shtetërore nuk është mundësuar ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese që vendosi pezullimin e procedurës së ekstradimit.
2. Ministria e Drejtësisë pavarësisht se ka qenë në dijeni të procesit të nisur si para Gjykatës Kushtetuese, ashtu edhe pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, mbi pezullimin e saj, nuk ka mbajtur asnjë komunikim vijues me institucionet e përfshira në procedurën e ekstradimit, për të parandaluar qënien në kushtet e mosekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, çka përbën cenim të parimeve të shtetit ligjor.
3. Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese në limitet e afateve të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë që kishte miratuar ekstradimin, ka ndikuar gjithashtu në kufizimin e mundësive reale për reagimin në kohën e duhur nga institucionet e tjera që po kryenin procedurën e ekstradimit.
4. KShH vlerëson se ka dyshime serioze se autoritetet shqiptare nuk kanë respektuar standardet ndërkombëtare dhe ato të parashikuara në legjislacionin tonë se ekstradimi i një personi nuk mund të lejohet kur në kohën e paraqitjes së kërkesës për ekstradim ai ka aplikuar për azil në Shqipëri.
5. KShH vlerëson se ky rast duhet ti shërbejë institucioneve shqiptare për të krijuar mekanizmat e nevojshëm që forcojnë komunikimin dhe bashkëpunimin ndër-institucional, në raste të ndjekjes së procedurave urgjente dhe që impaktojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Kalimi i përgjegjësive nga një institucion në tjetrin apo shmangia e tyre duke i qëndruar strikt argumentave formalë, është me pasoja të dëmshme për shtetin e së drejtës, duke sjellë shkelje flagrante të të drejtave dhe lirive të njeriut, sikurse ka ndodhur në rastin në fjalë.